



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

BUXHETI 2026

për

qytetarët

Një vështrim i thjeshtëzuar në
financat publike për vitin **2026**

Ky material mbështetet në Projektligjin për Buxhetin e Vitit 2026 të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 629 datë 3.11.2025. Ky material paraqet një variant të përmbledhur dhe jo shterues të propozimit të buxhetit 2026

Përdorimi i tekstit

Përdorimi i tekstit dhe të dhënave të paraqitura në këtë material, me kusht që të referohen pandryshim, lejohet me citimin e burimit:

Burimi: Ministria e Financave

Modifikimi i tekstit

Në rast se teksti, të dhënat apo grafikët e paraqitur këtu përdoren për të gjeneruar material apo të dhëna të ndryshme, preferohet citimi: Bazohet në të dhëna nga Ministria e Financave.

Informacione të tjera

Projektligji i plotë për Buxhetin 2026 dhe tabelat përkatëse janë botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:

www.financa.gov.al

Për informacione apo sqarime të nevojshme mund të drejtoheni në adresën: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Ministria e Financave, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë.

e-mail: budget.programming@financa.gov.al

Botimi i këtij dokumenti u mundësua nga Ministria e Financave

Nëntor 2025



20

BUXHETI PËR QYTETARËT

Një vështrim i thjeshtëzuar në financat publike për vitin
2026

26

Përmbajtja

BUXHETI PËR QYTETARËT 2026	4
MESAZH PËR LEXUESIN	5
TË DHËNA DEMOGRAFIKE	7
PUNËSIMI	8
RRITJA EKONOMIKE	9
TË ARDHURAT E BUXHETIT	10
SHPENZIMET E BUXHETIT	11
POLITIKAT PRIORITARE TË QEVERISË DHE FINANCIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR REALIZIMIN E TYRE	12
BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL	13
MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	15
INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA	16
SHËNDETËSIA	18
ARSIMI	20
MBROJTJA SOCIALE	21
DREJTËSIA DHE RENDI	22
MBROJTJA	23
ARGËTIMI, KULTURA DHE ÇËSHTJET FETARE	24
MBROJTJA E MJEDISIT	25
STREHIMI	26
DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK	27

Mesazh për lexuesin



Petrit MALAJ

Ministër i Financave

Të nderuar qytetarë,

Dëshiroj t'ju njoh shkurtimisht dhe në mënyrë të thjeshtuar me propozimin e buxhetit të shtetit për vitin 2026. Projektbuxheti 2026 është ndërtuar në përputhje me vizionin e qeverisë për një Shqipëri europiane, duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, si dhe reformat kyçe për përshpejtimin e procesit të integritetit.

Gjatë periudhës afatmesëme 2026-2028, rritja ekonomike parashikohet të jetë e qëndrueshme, mesatarisht në nivelin 4% në vit. Deficiti buxhetor planifikohet në 2.3% të PBB-së duke mundësuar një borxh publik më të ulët e që parashikohet të arrijë në 53.6% të PBB në fund të 2026.

Projektbuxheti i propozuar fokusohet në financimin me prioritet të sektorëve kyç për zhvillimin e vendit, si : arsimi, bujqësia, shëndetësia, mbrojtja sociale, infrastruktura rrugore dhe sistemet digjitale. Ai parashikon një nivel të lartë investimesh publike, që kapin vlerën mbi 6.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Synimi është të sigurohen burimet financiare të nevojshme për përparimin dhe përfundimin e projekteve strategjike në fushat e konektivitetit rrugor, hekurudhor dhe portual, si dhe në sektorët e tjerë me rëndësi të veçantë.

Për vitin 2026, të ardhurat totale buxhetore parashikohen të arrijnë në 823.1 miliardë lekë, me një rritje prej 6.8% krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2025. Bazuar në projeksionet tona totali i të ardhurave parashikohet të zërë 29.6% e PBB-së nga 28.1%, që kanë rezultuar mesatarisht në tre vitet paraardhëse, pra me një rritje mesatare prej 1.4% të PBB-së. Kjo rritje i atribuohet kryesisht përmirësimit të administrimit fiskal dhe reduktimit të informalitetit në ekonomi.

Në krahun e shpenzimeve buxhetore, në projektbuxhetin e vitit 2026, janë parashikuar 886.8 miliardë lekë ose 31.9% e PBB, me një rritje në vlerë absolute prej 55 miliardë lekësh, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2025. Një vëmendje e veçantë në këtë projektbuxhet do t'i kushtohet edhe financimit të rritjes së pensioneve, për të mundësuar garantimin deri në fund të mandatit, të pensionit minimal në nivelin e 200 euro/ muaj dhe pensionit mesatar në nivelin e 400 euro/ muaj.

Krahas kësaj politike, parashikohet edhe rritja e pagës minimale me 10 mijë lekë për të arritur në 50 mijë lekë në muaj, si dhe indeksimi i pagave për administratën publike, duke filluar nga data

1 Janar 2026. Buxheti i këtyre politikave është parashikuar përgjatë tre viteve të ardhshme, si një angazhim i qeverisë për të çuar përpara reformat, drejt Shqipërisë 2030.

Edhe në këtë projektbuxhet ne do të vijojmë të adresojmë çështje të lidhura, kryesisht në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë, rendit publik, por edhe të barazisë gjinore.

Rreth 9.5% e shpenzimeve të përgjithshme publike do t'i dedikohen politikave publike me bazë gjinore, që synojnë të shënjestrojnë dhe për pasojë të zvogëlojnë hendeqet gjinore.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2026, janë parashikuar në masën 97.7 miliardë lekë, me një rritje prej 9% më shumë se buxheti i vitit 2025. Këto shpenzime për vitin 2026, zënë 3.52% të PBB-së nga 3.4 që zinin në vitin 2025 ose nga 2.3% në vitin 2015. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2026, krahasuar me vitin 2025 është 1.6 miliard lekë më shumë ose rreth 6% më e lartë, dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale), është 15.5 miliardë lekë më shumë ose mbi dy herë më e lartë.

Projektbuxheti 2026 synon të përmirësojë jetën e përditshme të qytetarëve përmes rritjes së pagave dhe pensioneve, investimeve në shkolla, spitale dhe infrastrukturë, si dhe ruajtjen e stabilitetit ekonomik, duke siguruar më shumë mundësi dhe shërbime më cilësore për të gjithë qytetarët.

Faleminderit



TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Popullsia e Shqipërisë në janar 2025 rezultoi 2.36 milionë banorë, me një rënie me 1.2% krahasuar me vitin 2024, nga të cilët:

2.36

Milionë




1,193,474 gra dhe vajza

50.5

Rreth 17.6% e popullsisë përbëhet nga gra/vajza dhe burra/djem të moshës 20-34 vjeç, prej të cilëve/cilave 50.3% janë gra dhe vajza (16.2% e të cilave janë të moshës 25-29 vjeç).

1,169,840 burra dhe djem

49.5



Tirana vijon të jetë qarku me popullsinë më të lartë në vend me 759,981 banorë, nga të cilët 392,882 gra dhe vajza (ose 52%) dhe 367,099 burra dhe djem (ose 48%) e ndjekur nga Fieri (233,215 banorë, 50.% gra dhe 50% burra), Elbasan (226,963 banorë, 50% gra dhe 50% burra) dhe Durrës (222,999 banorë, 50% gra dhe 50% burra).

PUNËSIMI

Referuar statistikave të [INSTAT](#) shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 69.1%.

75.7% për burrat
62.6% për gratë



Sipas vlerësimeve të anketës për vitin 2024, e publikuar në Gusht 2025, rezulton se për grupmoshën 15 vjeç e lart, 45.7 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 30.1% janë vetëpunësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 24.2% janë punëtorë pa pagesë në biznesin familjar.

Shkalla e Punësimit (15-64 Vjeç)
2025

75.7%

Burra

62.6%

Gra

Papunësia

8.5%



Paga mesatare bruto për T2 2025 rezulton 83,906 lekë




RRITJA EKONOMIKE

Rritja ekonomike parashikohet në rreth 3.9% në vitin 2025, e mbështetur nga e mbështetur nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet dhe nga ecuria mjaft e mirë e sektorit të shërbimeve, veçanërisht turizmi.

Për periudhën afatmesme 2026-2028, rritja parashikohet mesatarisht në rreth 4% në vit. Edhe gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga faktorët e më lartë përmendur.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme 2026 – 2028 parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 2.5% në vit, duke kontribuar me afërsisht rreth 2.1 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB*-së. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real me rreth 6.7% duke dhënë një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.7 pikë përqindje në vit.



Inflacioni mesatar pritet të qëndrojë stabël në nivelin 3% përgjatë 2026-2028 ndërsa Prodhimi i Brendshëm Bruto për banor (PBB/banor) pritet të rritet nga 1107.4 mijë lekë për banor në vitin 2025 në 1170.3 mijë lekë për banor në vitin 2026.


RRITJA
EKONOMIKE

4%

*Produkti i Brendshëm Bruto

TË ARDHURAT E BUXHETIT

Në vitin 2026, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 823.1 miliardë lekë (ose 29.6% të PBB), prej të cilave, të ardhurat tatimore zënë 773 miliardë lekë (ose 27.8% të PBB) dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat janë 531.1 miliardë lekë (ose 19.1% të PBB). Të ardhurat nga kontributet planifikohen të jenë 198 miliardë lekë (ose 7.1% të PBB).



SHPENZIMET E BUXHETIT

6.5% PBB

Investime Publike

**886.7
miliardë
lekë**

Mbrojtja Sociale – 257.26

Shërbimet e Përgjithshme Publike * – 144.65

Mbrojtja – 43.01

Rendi dhe Siguria Publike – 59.39

Mbrojtja e Mjedisit – 8.12

Çështjet Ekonomike – 123.95

Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit – 60.56

Shëndetësia – 81.16

Arsimi – 89.83

Argëtimi, Kultura dhe Çështjet Fetare – 12.5

Kontingjenca e Risqeve të Borxhit – 6.3


Projektbuxheti i vitit 2026 për Shqipërinë është ndërtuar për të përmirësuar jetën e qytetarëve, duke rritur investimet në shëndetësi, arsim, infrastrukturë dhe mbrojtje sociale. Parashikohet rritje e pagës minimale në 50,000 lekë, bonusi mujor për pensionistët përtej indeksimit vjetor, më shumë fonde për spitale dhe shkolla, si dhe projekte të reja për rrugë dhe energji. Qeveria synon të forcojë mbrojtjen kombëtare dhe i kushton më shumë vëmendje bujqësisë dhe prodhimit vendas. Ky buxhet është një hap drejt zhvillimit dhe përmirësimit të shërbimeve për të gjithë qytetarët

Shpenzimet e personelit për vitin 2026, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, koston e plotë të indeksimit të pagave në nivelin 2.5% si dhe efektet e hyrjes në fuqi të pagës minimale prej 50 mijë lekë në muaj. Kostoja totale e rritjes së pagës minimale së bashku me indeksimin parashikohet rreth 10 miliardë lekë. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike në nivel qendror për 87,112 punonjës planifikohen në masën 140.1 miliardë lekë ose 5% e PBB.

*Në shpenzimet e këtij funksioni që zënë rreth 5.2% të PBB, përfshihen kostot e funksionimit të administratës qendrore dhe vendore, shpenzimet e interesave, fondi i veçantë i pagave dhe shpenzimet e të ardhurave të tjera jashtë limitit

POLITIKAT PRIORITARE DHE FINANCIMI PËR REALIZIMIN E TYRE

Shtyllat kryesore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve në Shqipëri do të jenë: mbrojtja sociale, arsimi, shëndetësia, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional të të rinjve rinjve dhe të rejave, mbështetja proaktive ndaj biznesit, sidomos atij rural dhe turizmit.



BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është planifikuar në masën 16.25 miliardë lekë.

1. Prioritetet e sektorit të bujqësisë

- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë.
- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- Mbështetje për agroindustrinë.

- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas.



- Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin.
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmytjeve.
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

- Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimi i përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.



ZHVILLIMI RURAL



Sa i përket politikave të zhvillimit rural, prioritet do të jetë edhe:

- Rritja e numrit të grave që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor- ku 540 gra do të përfitojnë shërbime të targetuara informacioni dhe këshillimi bujqësor me një fond prej 2,500,000 lekësh.
- Shtimi i numrit të përfituesve nga masat mbështetëse në bujqësi në 15 000 përfitues në vitin 2026, si dhe rritja e numrit të përfituesve nga Skema e Subvencionit të naftës për bujqësinë në 30,000 përfitues në vitin 2026 dhe 300 përfitues nga Skema e investimeve me grante në fermë.
- Aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim.

- Rritja e volumit të eksportit të produkteve bujqësore dhe të agro-përpunimit nga 55.8 miliardë lekë në vitin 2025 në 59.7 miliardë lekë në vitin 2027.
- Rritja e përqindja e sipërfaqes ujitëse ku fermerët kanë akses në ujë për ujitje, kundrejt sipërfaqes potencialisht të ujitshme (360 000 ha).
- Numri i të punësuarve në bujqësi dhe agro-përpunim (nga 459 068 të punësuar të parashikuar në vitin 2024 në 495 073 të punësuar në vitin 2027).



MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Prioritetet sa i përket mbështetjes së zhvillimit ekonomik do të jenë:



- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në panaire ndërkombëtare dhe "road show" promovuese, vizita në kompani (after care), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS) 2021-2027.
- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve "Made in Albania".



- Marrja e masave për të rritur konkurrueshmërinë e mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nëpërmjet aksesit në financë përmes Fondit të Zhvillimit për ndërmarrjet, të parashikuar në ligjin nr. 43/2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme".
- Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe bizneseve, përmes aksesit të lehtë të informacionit.
- Zhvillimi i një qasje gjithëpërfshirëse në mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në integrimin e zinxhirit të vlerave globale përmes pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin Evropian të Tregut të Përbashkët 2021-2027, në shtyllën e NVM-ve.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

Buxheti në dispozicion për prioritetet në këtë fushë është rreth 77.2 miliardë lekë.

2.8% e PBB

- Rritja e numrit të përfituesve direkt dhe indirekt si përdorues të rrjetit rrugor, nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zgjerimi i aksesit si dhe rritja e cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes investimeve publike; dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimeve, duke standardizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e eficiencës së energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme.

Në programin e rrugëve kombëtare do të financohen me prioritet:

- Mirëmbajtja sipas standardeve të 3,522 km rrugë në territorin e Republikës së Shqipërisë, me fond total për shpenzimet e mirëmbajtjes prej 3.6 miliardë lekë.
- Financimi i rrugës “Elbasan-Lekaj” si dhe “Zgjerimi i Autostradës Tiranë – Durrës”.
- Vijimi i zbatimit të projekteve prioritate si:
 - Ndërtimi i Rrugës së Arbrit;
 - Ndërtimi i Rrugës Milot – Morinë;
 - Ndërtimi i Rrugës Orikum – Dukat, ByPass-Porti i Jahteve.



Shërbimet për ujësjellës - kanalizime do të vijojnë të financohet për të përmirësuar treguesit, si më poshtë:

- Furnizimin me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 23 orë në ditë në vitin 2028;
- Rritjen e numrit mesatar të orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar në 21 orë në ditë deri në 2028, nga 19 orë në ditë në vitin 2026;
- Shtimin dhe përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm në zonat urbane me 97% dhe në zonat rurale me 75% deri në vitin 2028.



Planifikimi urban do të synojë më shumë lëvizshmëri dhe infrastrukturë të sigurt, përmes:

- Zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit, duke zbutur pabarazinë rajonale;
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – Terminali i Pasagjerëve Tiranë;
- Ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë – Rinas dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Vorë – Hani i Hotit .



SHËNDETËSIA

**Politikat
prioritare të
zhvillimit të
shëndetësisë
do të
financohen me
rreth 81.2
miliardë lekë.**

- Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore).



**2.9% e
PBB**

- Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare të institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit më efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve.
- Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave e pajisjeve të rimbursueshme, ku do të mbështeten 400 mijë qytetarë me barna të rimbursueshme përfshirë dhe barna anti-tumorale;
- Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike për të gjitha gratë dhe burrat e grupeve të ndryshme socialepërfshirë këtu paketën e re për trajtimin e trombektomisë;;
- Pagesa për kujdesin shëndetësor për të gjitha gratë dhe burrat e grupeve të ndryshme sociale, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
- Kostoja e shërbimeve të reja shëndetësore, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore;

Politikat shëndetësore do të vijojnë të mbështesin nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor dhe dytësor, ku rëndësi të veçantë zënë investimet në maternitete me rreth 240.9 milionë lekë për vitin 2026.

Depistimi për kancerin e gjirit për mesatarisht 5000 gra në vit përgjatë 2026-2028 duke synuar parandalimin e rasteve e duke rritur depistimin për kancerin e gjirit të grave mbi 35 vjeç nga 38% në vitin 2025 në 44% në vitin 2028;

- Depistimi për kancerin e qafës së mitrës me mesatarisht 12 500 gra në vit, përgjatë 2026-2028 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës, me një fond mesatarisht prej 28 milion lekë përgjatë periudhës 2026-2028.
- Financimi për herë të parë falas i ndërhyrjes kirurgjikale për rikonstruksionin e gjirit (proteza e gjirit) për pacientët e sëmurë me kancer gjiri nga e cila pritet të përfitojnë rreth 350 gra në vit, përgjatë 2026-2028
- Financimi i politikës së paketave të fertilitet për çiftet që kanë nevojë për të bërë ëndrrën e tyre realitet dhe për të pasur një fëmijë përgjatë periudhës 2026-2028 duke parashikuar mesatarisht 200 pacientë përfitues.



ARSIMI

3.2% e PBB

Fondet për sektorin e Arsimit në vitin 2026, parashikohet të arrijnë në 89.8 miliardë lekë.

Politikat kryesore për zhvillimin e arsimit gjatë këtij viti synojnë:

- Ofrimin e teksteve shkollore falas për 220 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe ofrimi i bursave financiare apo kuotë ushqimore/financiare për 4000 nxënës me nevoja të veçanta;
- Tekstet shkollore falas për arsimin e mesëm ku do të përfitojnë dhe vajzat që vijnë nga familje në nevojë dhe/apo viktimat të trafikimit;
- Sigurimin e shërbimit të transportit për 35 mijë vajza dhe djem që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe për rreth 13,500 mësues/e që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë;
- Financimi i programit pilot të kujdesit passhkollor (after school)

Punësimi dhe aftësimi profesional

Politikat e punësimit dhe të arsimit profesional për gratë dhe vajzat vijojnë të jenë prioritet, ashtu sikurse edhe politikat e mbrojtjes sociale të strehimit social apo të sigurimeve shoqërore, të cilat synojnë jo vetëm fuqizimin, por edhe ndihmën specifike ndaj atyre që janë viktimat të dhunës më baza gjinore apo në familje.

- Modernizimi i infrastrukturës së ofruesve publik të AFP-së, në përputhje me parimet e ekonomisë dhe transformimit digjital;
- Rritja e aksesit në Arsimin e Mesëm Profesional duke synuar që në vitin 2028 të tërhiqen 20% e nxënësve që ndjekin ciklin e Arsimit e Mesëm, nga 17.7% që parashikohet të arrijë në fund të vitit 2025;
- Punësimi nga programet e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave në 744 nga 1180;
- 420 të rinj vajza e djem përfitues të nismës Garancia Rinore;
- 7900 të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional Publik;



MBROJTJA SOCIALE

Projektbuxheti 2026 garanton rritjen e qëndrueshme të mburojës sociale për shtresat në nevojë, me fokus fëmijët, nënat më shumë fëmijë, të moshuarit dhe familjet.

- Buxheti për programet e mbrojtjes sociale garanton mbështetjen e 61 mijë familjeve ër vitin 2026, pjesë e programit të ndihmës ekonomike, ku rreth 40% të përfituesve janë gra të dhunuara.



9.2% e PBB

- Mbështetje për programin e pagesave për 94 mijë përfitues me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre.
- Vijnë financimi i politikës së mbështetjes së veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri 5 vjeç. Për vitin 2026 parashikohet të përfitojnë 8 300 gra me një kosto prej 850,000,000 lekësh.
- Mbështetje për skemën e pensioneve dhe skemat e tjera të mbështetjes për 780 mijë përfitues për vitin 2026;
- Në shpenzimet buxhetore për periudhën 2026-2028 sigurohen burimet e nevojshme për arritjen e angazhimit të Qeverisë për rritjen e pensionit minimal në nivelin e 200 Euro në muaj dhe atij mesatar në nivelin e 400 Euro në muaj.
- Vijnë financimi i Programit të “Bonusit të Bebes” për çdo të porsalindur, duke garantuar shpërblimin financiar nga 40,000-120,000 lekë për rreth 33 mijë fëmijë/vit, si një mënyrë për të ndihmuar nënat dhe baballarët e rinj, për të përballuar muajt e parë të lindjes së bebes.
- Pagesa për barrë lindje për 14,329 nëna ose baballarë me një vlerë 6.1 miliardë lekë.

DREJTËSIA DHE RENDI

2.1% e PBB

Shpenzimet buxhetore për Drejtësinë dhe Rendin Publik parashikohen në masën 59.4 miliardë lekë. Nëpërmjet këtyre fondeve do të mundësohet:

- Sigurimi i kushteve të përshtatshme për rreth 5,500 të dënuar burra, 86 të dënuar gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe trajtimin me shërbim shëndetësor për 438 të dënuar të sëmurë, me fondin total në rreth 2.2 miliardë lekë.
- Ri-integrimi nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standardet evropiane, për rreth 360 të dënuar burra, 2 gra dhe 6 të mitur.
- Ofrimi i ndihmës juridike falas për rreth 5,000 individë në total, që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, prej të cilëve 3,000 ose 60% të totalit, gra dhe vajza.
- Realizimi i rreth 19,000 akteve të ekspertimit të klasifikuara si; mjeko-ligjore, toksikologjiko-ligjore, biologjiko-ligjore dhe psikiatriko-ligjore, në përputhje me standardet evropiane.



- Mbikëqyrja në mënyrë efektive e 7000 burrave, 800 grave dhe 200 të miturve gjatë shërbimit të provës.
- Realizimi i skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 842 vendime të trajtuara me kompensim kundrejt totalit të vendimeve të Regjistrimit elektronik të ATP-së të parashikuar për vitin 2026, në 2,343 për vitin 2028;
- Garantimi i interesit më të lartë të fëmijëve, nëpërmjet vendosjes në familje të përhershme që përshtaten me nevojat specifike të secilit prej tyre, me synimin që 100% e totalit të birësimeve të rezultojnë të suksesshme
- Rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet duke synuar shpejtësinë e reagimit të shërbimeve policore në 13 minuta në vitet 2026-2028;
- Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje 13 minuta në vitet 2026-2028.



MBROJTJA

2.12% e PBB

Buxheti i vitit 2026 i Ministrisë së Mbrojtjes do të arrijë në 58.95 miliardë lekë, nëpërmjet të cilit garantohet:

- Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakëve gra dhe burra.
- Aktiviteti i personelit për 755 ushtarakë të forcave ajrore, 1,350 personel i Forcave të Armatosura, ku rreth 15% e tyre janë gra dhe vajza me dhe pa uniform.
- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjente në Spitalin e Traumës parashikohet mesatarisht 98 502 pacientë.
- Mbështetje për aktivitetin e 895 punonjësve të arsimuar sipas kriterëve dhe standarteve të NATO-s.
- Trajtim i veçantë për 30,298 ushtarakë në rezervë dhe në lirim.
- Numri i operacioneve të planifikuara dhe urgjence parashikohet mesatarisht 69 mijë operacione në Spitalin e Traumës.
- Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione i Forcave të Armatosura.
- Zbatimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, etj. i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë.



ARGËTIMI, KULTURA DHE ÇËSHTJET FETARE

0.4% e PBB

Shpenzimet për argëtimin, kulturën dhe çështje fetare parashikohet të arrijnë në 12.5 miliardë lekë, duke synuar financimin e projekteve me rëndësi për ruajtjen e kulturës dhe traditës, bashkëjetesës fetare, zhvillimit të artit dhe turizmit kulturor në Shqipëri.

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Parashikohen rreth 156 objekte të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura në periudhën 2026-2028.
- Rritja e mbështetjes për aktiviteteve të fushës së trashëgimisë kulturore rreth 110 aktivitete të mbështetura financiarisht në vitet 2025-2028.
- Rritja e numrit të objekteve të regjistruara në databazën kombëtare të trashëgimisë, rreth 140 mijë në vitet 2026 – 2028.
- Rritja e numrit të projektve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese, duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi nga 272 në vitin 2025, në 275 në vitin 2026, 278 në vitin 2027 dhe 280 në vitin 2028.
- Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve).
- Ndërtimi i Godinës së Teatrit Tiranë.
- Zhvillimi i rreth 700 aktiviteteve sipas kalendarëve artistikë të programuar nga institucionet qendrore publike të artit dhe kulturës.
- Mbështetja e skenës së pavarur për të mundësuar edukimin përmes kulturës, si dhe përfaqësimi i produktit artistik në arenën elitare ndërkombëtare.
- Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave.
- Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjës muzeore në Muzeun Historik.





Në sektorin e kulturës do të vijohet t'i jepet përparësi:

- Grave dhe vajzave artiste që promovojnë aktivitetet skenike;
- Grave dhe vajzave artizane që ruajnë dhe trashëgojnë më tej vlerat dhe traditat e kulturës shqiptare.

MBROJTJA E MJEDISIT

Ekonomia e gjelbër, po merr gjithnjë e më shumë vëmendje në zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, reduktimin e efekteve të ndryshimeve klimatike, por edhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ky sektor do të financohet me 8.1 miliardë lekë ose 0.3% të PBB dhe do të fokusohet ndër të tjera në:

- Diversifikimin e produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjeter, duke promovuar gjerësisht Shqipërinë në komunitetin ndërkombëtar, si një destinacion të denjë për të konkurruar globalisht.
- Ofrimin e incentivave për rritjen e numrit të bizneseve në sektorin e agroturizmit.
- Arritjen e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit.
- Përmirësimin e performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Rritjen e përqindjes së mbetjeve që shkojnë në landfille sanitare kundrejt mbetjeve të hedhura në venddepozitime të hapura, në 68%.
- Rritjen e përqindjes së mbetjeve të ricikluara në 20% në vitin 2028 nga 19% e parashikuar në vitin 2026.
- Rritjen e punësimit në sektorin e turizmit me 8.8% deri në vitin 2028.



STREHIMI



Objektivi i këtij programi është të sigurojë, deri në vitin 2030, strehim të përshtatshëm e të përballueshëm për rreth 35,000 individë/familje që kanë aplikuar për strehim dhe që nuk përballojnë dot kostot e tregut të banesave.

Për vitin 2026 parashikohen 1.25 miliardë lekë për financimin e :



- Pagesës së bonusit të qirasë për rreth 1,900 familje përfitues me një fond prej 200 milionë lekë.
- Skematve të investimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës për gra dhe burra nga grupet sociale. Parashikohen mesatarisht 350 familje përfituese në nevojë, me një kosto prej 350 milionë lekë.
- Subvencionim e qirasë për të shpronësuar 92 familje përfituese nga projekti i Unazës së Madhe të Tiranës, me një kosto prej 10 milionë lekë.
- Për gratë dhe vajzat e dhunuara, apo familjet me një prind, do të vijohet mbështetja me strehim social. Kostoja për strehimin social të 2,000 të grave dhe vajzave të kategorive të përcaktuara sipas ligjit do të jetë 132,354,591 lekë.

DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK

Deficiti buxhetor për vitin 2026 planifikohet të jetë në nivelin 2.3% të PBB. Balanca primare pritët të jetë pozitive për vitin 2026.

Balanca e përgjithshme e qeverisë (Deficiti fiskal në % të PBB)

	2022	2023	2024	2025*
<i>Balanca fiskale, (në % ndaj PBB)</i>				
Shqipëria	-3.6	-1.3	-0.7	-2.5
Bosnja dhe Hercegovina	-0.4	-1.2	-1.8	-1.5
Kosova	-0.5	-0.3	-0.3	-0.8
Maqedonia	-4.3	-4.4	-4.6	-4
Mal i Zi	-3.7	0.6	-3.1	-3.7
Serbia	-3	-2.1	-2	-3
Mesatarja e rajonit	-2.6	-1.4	-2.1	-2.6

Në vitin 2025 parashikohet që Borxhi Publik Bruto të ulet në rreth 54.1 përqind të PBB-së dhe pritët të vijojë të bjerë më tej në rreth 53.6% në vitin 2026. Sipas skenarit bazë, Borxhi Publik Bruto pritët të bjerë në rreth 51% në vitin 2028 dhe më tej në rreth 46.4% në vitin 2031.

	2022	2023	2024	2025*
<i>Borxhi publik dhe i garantuar (në % ndaj PBB)</i>				
Shqipëria	64.1	57.6	54.2	53.4
Bosnja dhe Hercegovina	29.3	26.4	26.3	24.5
Kosova	19.7	17.2	16.9	16.8
Maqedonia	49.6	49.7	53.8	55.2
Mal i Zi	69	58.4	59.8	59.4
Serbia	50.5	46.6	45.4	44.7
Mesatarja e rajonit	47	42.7	42.7	42.3

DEFICITI

2.3

BORXHI

53.6

Copyright: Ministria e Financave
Credits: Besjon Tanuzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE